



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 200, Datë 12.12.2019

MBI

**SHTYRJEN E FUQISË JURIDIKE TË VENDIMIT TË ERE NR. 268, DATË
21.12.2018, PËR ÇMIMET ME PAKICË PËR KLIENTËT FUNDORË QË
SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, nenit 20, gërma “c”, nenit 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 114/17/1 Prot, datë 10.12.2019, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.08.2018, në lidhje me tarifën e përdorimit të rjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019, për vitin 2020,

Konstatoi se:

- Bazuar në nenin 19, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ERE është institucioni përgjegjës për miratimin e tarifave për veprimtaritë e licencuara për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik.

- Në mbështetje të nenit 19, nenit 20 gërma c, nenit 83, nenit 85 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; VKM-s nr. 244 datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe përcaktimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal të furnizimit.

- ERE me vendimet nr. 182, datë 10.11.2017, dhe nr. 189, datë 23.11.2017 të Bordit të ERE-s, ka miratuar “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike” si dhe “Metodologjinë e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU)”;

- ERE me shkresën nr. 541, datë 10.09.2019, i është drejtuar shoqërisë OSHEE sh.a. me kërkesën dhe kujtesën për paraqitjen e aplikimit për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që furnizohen nga FSHU për vitin 2020.
- Shoqëria OSHEE sh.a. nuk ka paraqitur pranë ERE-s aplikim bazuar në detyrimet sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesës së lartpërmendur.
- Në këto kushte, bazuar në nenin 20 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ERE ka të drejtën të miratojë tarifa të përkohshme në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave.
- Me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, të Bordit të ERE-s, është vendosur periudha tranzitore prej 12 muajsh, për bërjen efektive të transferimit të licencave:
 - të Operimit të Sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike, të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, (OSHEE sh.a.), tek shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. "OSSH sh.a);
 - të furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimin të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a), tek Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHUsh.a).
- Në kuptim të vendimit të ERE sa më sipër, Shoqëria “OSHEE” sh.a. kishte detyrimin për të paraqitur pranë ERE-s aplikim në përputhje me “*Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 10.11.2017 dhe “*Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal*”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 189. datë 23.11.2017.
- Me vendimin nr. 268, datë 21.12.2018 bordi i ERE ka vendosur : Të lërë në fuqi pikën 1 dhe pikën 3 të vendimit të bordit të ERE-s Nr. 190, datë 30.08.2018, “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSHEE” sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes të energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018”.
 - Me vendimin Nr. 190, datë 30.08.2018, në pikën 3 është vendosur mbi :
 3. Lënien në fuqi për vitin 2018, të pikave 3, 4 dhe 5 të vendimit të bordit të ERE-s, Nr.211, datë 28.12.2017, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a., për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënies në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018”.
 4. Lënien në fuqi të vendimit nr. 53, datë 6.4.2016, "Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi universal për kategorinë objekte kulti/bashkësi fetare, datë 6.4.2017".

5. OSHEE sh.a., përveç shlyerjes së detyrimeve korente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a. dhe KESH sh.a..

- Me mbylljen e periudhës tranzitore, të parashikuar në vendimin e bordit të ERE nr. 264, datë 20.12.2018, aplikimi i shoqërisë FSHU sh.a., edhe në rast se adresohet pas shterimit të fuqisë juridike të vendimit të ERE sipër cituar, nuk lë kohën e mjaftueshme për vlerësimin dhe miratimin nga ERE, brenda vitit 2019.
- Në mënyrë që shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a), me bërjen efektive të ndarjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për vitin 2020, të mundet të realizojë aktivitetin për të cilin është licencuar, konform Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjise Elektrike”, i ndryshuar, është e domosdoshme që faturimi për shërbimet që kjo shoqëri ofron të mund të bëhet mbi çmime të miratuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2020, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal si më poshtë:

Çmimi I shitjes për Klientët në 20 kV *	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh	
Çmimi I shitjes për Klientët në 10/6 kV *	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh	
* Miratim i përkohshëm për klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lart		
Çmimi I shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	12.4 Lekë/Kwh Në Pik 14.3 Lekë/Kwh	
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	*Çmimet paraqiten në tabelën më poshtë	
ÇMIMET E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIEN TËT FUNDOR		
Niveli I tensionit	Çmimi (Leke/kWh)	Çmimi pik (Leke/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Leke/Muaj)	200	
*Çmimi I energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive		
*Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është :		
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

2. OSHEE sh.a. në funksion të OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., përveç shlyerjes së detyrimeve korrente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. për detyrimet e prapambetura në përputhje me parashikimet e VKM nr. 253, datë 24.04.2019, “*Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik elektroenergjitik*”.
3. Lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr. 53, datë 06.04.2017, “Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi universal për kategorinë objekte kulti/bashkësi fetare” për vitin 2020.
4. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë FSHU sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 20, gërma “c” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.
5. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga 01.01.2020.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI